

STAMBOLLI NË “SEJAHATNAMENË” E EVLIJA (EVLIYA) ÇELEBIUT

Evlija Çelebiu, emri i vërtetë i të cilit është Dervish Mehmed Zilli ishte funksionar, udhëtar, intelektual dhe shkrimtar osman, i cili jetoi në shek. XVII. Ai mendohet të ketë lindur në vitin 1611 në qytetin e Stambollit dhe ka vdekur në vitin 1684. Për një periudhë rreth dyzet vjeçare ai ka shëtitur thuajse të gjithë hapësirën e Perandorisë Osmane, por edhe në shtete të tjera të Evropës, duke na dhënë informacione të rëndësishme mbi jetën sociale, shoqërinë, kulturën, gjuhën, traditat, historinë dhe fenë e shumë vendeve nëpër të cilat ka udhëtuar. Ajo çka e habit studiuesin në lidhje me Çelebiun është diapazoni i tij i gjerë intelektual, po të kemi parasysh se në “Sejahatname” ai flet për çështje të cilat u përkasin fushave dhe shkencave të ndryshme, kulturës, fesë, arkitekturës, gastronomisë etj. Jo më kot, emri dhe vepra e tij u vlerësuan nga UNESCO duke e shpallur vitin 2011 si vitin e Evlija Çelebiut.

Vepra e tij, “Sejahatnameja”, (“Libri i udhëtimeve”) na del përpara si një vepër me rëndësi të veçantë nisur nga fakti se ajo na paraqet një panoramë ekonomike, administrative, kulturore e historike të një pjese të konsiderueshme të hapësirës territoriale të Perandorisë Osmane të shek. XVII. Në vetvete, kjo vepër është një shembull dhe burim i dorës së parë për të kuptuar historinë kulturore e shoqërore të zonave e rajoneve në veçanti, dhe atë të Perandorisë Osmane në përgjithësi. Rëndësinë e kësaj vepre e tregon më së miri numri i madh i ribotimeve të saj, i përkthimeve në shumë gjuhë të ndryshme dhe i një numri të madh artikujsh, shkrimesh, monografish të karakterit akademik që janë shkruar mbi këtë punim. “Libri i udhëtimeve” përbëhet prej dhjetë vëllimesh dhe fillon me përshkrimin e qytetit të Stambollit e më pas vijon me vendet e shëtitura prej Evlija Çelebiut që janë përfshirë në nëntë vëllimet e tjera. Vendet që ai ka shëtitur sipas vëllimeve me radhë janë: 1. “Stambolli dhe rrethinat”; 2.

“Anadulli, Kaukazi, Kreta dhe Azerbajxhani”; 3. “Siria, Palestina, Armenia dhe Rumelia”; 4. “Veriu i Anadollit, Iraku dhe Irani”; 5. “Rusia dhe Ballkani”; 6. “Hungaria, Bosnja dhe vendet përreth”; 7. “Austria, Krimeja dhe sërish Kaukazi”; 8. “Krimeja dhe vende të ndryshme të Rumelisë”; 9. “Haxhi drejt Mekës”; 10. “Egjipti dhe Sudani”. Studiuesit turq i kanë përkthyer në turqishten e sotme shtatë vëllimet e para, ndërsa tri të fundit ende mbeten në gjuhën osmane.

Për lexuesin shqiptar kjo vepër nuk është e panjohur. Më herët është botuar një përkthim i disa pjesëve të “Sejihatnamesë”, që flasin për hapësirën shqiptare, përkthyer nga Sali Vuçiterni me titullin “Shqipëria para tre shekujsh”. Gjithashtu, edhe albanologu Robert Elsie, bashkë me Robert Dankoff, në vitin 1999 kanë botuar në gjuhën angleze vëllimin “Evlia Çelebi in Albania and Adjacent Regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)”, vepër në të cilën janë përmbledhur pjesë nga vëllimet V, VI, VIII të “Sejihatnamesë”. Por, na duhet të theksojmë se të dhënat për shqiptarët dhe hapësirën shqiptare i gjen pothuajse në të dhjetë vëllimet e kësaj vepre të rëndësishme.

Vetë Çelebiu mendohet se i ka vizituar hapësirat shqiptare gjatë viteve 1660, 1662 dhe 1670, duke na lënë pas të dhëna me shumë rëndësi për gjuhën, dialektet, zakonet, kulturën, qytetet, kalatë, arkitekturën, fenë, ushqimet, rrugët, panairët, vendet e çlodhjes e shumë elemente të tjera të historisë sociale. Parë nga ky aspekt, të dhënat që nxjerrim nga “Sejihatnameja” na shërbejnë për të kuptuar më mirë gjeografinë e shqiptarëve gjatë shek. XVII, elemente të përditshmërisë dhe jetesës së tyre. Të dhënat që ai na jep për Gjirokastrën, Vlorën, Beratin, Elbasanin, Shkodrën, Ulqinin etj., na shërbejnë si burime të rëndësishme për historinë e qyteteve shqiptare, por edhe për të kuptuar gjendjen e hapësirave shqiptare gjatë sundimit osman.

Përveç botimeve të pjesëve fragmentare nga vepra kolosale e Evlia Çelebiut, të cilat u përmendën më sipër, për herë të parë në vitin 2018, shtëpia botuese “Fan Noli” vendosi ta sjellë në gjuhën shqipe këtë burim kaq të rëndësishëm. Kështu, si hap i parë u realizua përkthimi i vëllimit të parë të “Sejihatnamesë” që flet për qytetin e Stambollit dhe vendet përreth. Rreth njëmijë faqe përshkruajnë këtë qytet magjik nga themelimi i tij deri në shek. XVII, kohë kur vetë Çelebiu kishte jetuar.

Në lidhje me përkthimin e “Sejihatnamesë” vlen të parashtrijmë disa kritere që kemi ndjekur gjatë këtij procesi. Fillimisht, duhet të theksojmë se përkthimi në gjuhën shqipe i kësaj vepre është bërë nga versioni i saj në gjuhën e sotme turke. Në pjesën dërrmuese i kemi qëndruar stilit të Evlija Çelebiut i cili shkruan me fjali të gjata. Ndërsa për strofat, bejtet apo poezitë që bëjnë pjesë në vëllim e që janë të shkruara kryesisht në gjuhët perse e arabe kemi ndjekur rrugën e përshtatjes së tyre.

Vepra në fjalë përdoret edhe si burim prej shumë studiuesve në punimet e tyre lidhur me periudhën që trajton ajo. Për këtë arsye, lidhur me emrat e njerëzve, toponimet dhe termat e shumtë që kalojnë në tekst kemi preferuar të mos i përkthejmë por t’i lëmë ashtu siç janë në terminologjinë osmane. Të njëjtën rrugë kemi ndjekur edhe lidhur me instrumente, vegla pune apo muzikore, profesione e emërtime, të cilat jo vetëm që nuk e kanë përkthimin në gjuhën shqipe por, në të njëjtën kohë mund t’i përkasin periudhës së Evlija Çelebiut dhe nuk kanë arritur deri në ditët tona. Megjithatë, në rastet kur e kemi parë të nevojshme, me paranteza kemi dhënë një shpjegim të shkurtër të disa termave që përdoren në libër.

Për arsye se vëllimet e kësaj vepre janë voluminoze dhe për të qenë sa më të përdorshëm për lexuesin, e kemi ndarë secilin vëllim në dy pjesë, metodë të cilën e kanë përdorur edhe studiuesit turq në përkthimin e kësaj vepre nga gjuha osmane në turqishten e sotme.

Në këtë vëllim gjejmë shumë të dhëna mbi shqiptarët, karakterin dhe tiparet dalluese të tyre, vendet ku ata jetojnë në Stamboll, profesionet me të cilat merreshin, sadrazamët apo vezirët me origjinë shqiptare dhe elementë të tjerë që kanë lidhje me ne. Kështu, vetë Çelebiu sa herë flet për shqiptarët shprehet se janë një komb inatçi, duke theksuar vendosmërinë e tyre, por edhe këmbënguljen si një tipar dallues nga popujt e tjerë. Nga ana tjetër, ai bën edhe hamendësime të pabaza kur lidh zonën e Kurveleshit me fisin arab të Kurejshëve.

Çelebiu përshkruan periudhën e sundimit të secilit prej sulltanëve osmanë duke përmendur edhe emrat e sadrazamëve, vezirëve, dijetarëve, poetëve e arkitektëve më të shquar. Aty hasim shumë emra me origjinë shqiptare duke filluar që nga Ibrahim Pasha, i cili vuri qetësi në Egjipt gjatë viteve 1520, për të

kaluar te veziriazami intelektual i sulltan Sulejmanit, Lutfi Pasha, për të vijuar me sadrazamët e mëdhenj që dolën nga dinastia e Kopyrylyve, tek poeti i njohur Jahja bej Dukagjini deri tek admirali kara Mustafa Pasha e shumë vezirë e funksionarë të tjerë. Autori thekson origjinën e tyre, funksionet që kanë pasur, sukseset e arritura, por edhe veprat e bamirësisë që kishin ndërtuar e lënë pas.

Evlija Çelebiu na flet për profesionet me të cilat merreshin dhe shquheshin shqiptarët që jetonin në Stamboll, duke filluar që nga përgatitja e pijeve dhe e gjellëve si bozë, salep, hardalli, prodhimin dhe tregtinë e djathit, përgatitjen e mëlçive etj. Gjithashtu ai na tregon që shqiptarët kishin edhe profesione të tjera siç është ai i shtrimit të kalldrëmit apo dhe zhytja në thellësi të detit për të nxjerrë baltë, e cila shërbente për poçeri dhe për prodhimin e tjegullave.

Këto dhe shumë të dhëna të tjera që gjenden në mesin e fletëve të “Sejahatnamesë” jo vetëm që na japin informacione të rëndësishme mbi qytetin e magjishëm të Stambollit, qendër e botës për më shumë se njëmijë vite por, gjithashtu na tregojnë edhe kontributin e madh që shqiptarët dhanë në këtë qytet madhështor.